

otadžbine, 47; AIS, Zona..., 56, FDH-16913; Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998., <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/1-9/9769.html>, FDH-31078; *Pucali na civile u pogrebnoj povorci*, Politika, 14.05.1998, 15, FDH-34249.

### Malush (Miftar) Morina

(10.05.1944, shqiptar nga Ratkoci/Ratkovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor, katër fëmijë)

Në datën **12.05.1998**, forcat serbe kanë hyrë në **Ratkoc/Ratkovac** dhe u stacionuan në afërsi të shkollës fillore. Shumica e banorëve u strehuan te Malushi. Në shtëpinë e tij rastisën të ishin afro 40 burra, kur policia serbe erdhi në oborrin e tij. Malushi doli jashtë shtëpisë për të biseduar me policinë. Pas pak, u dëgjuan të shtëna. Pas largimit të policisë, familjarët e gjetën Malushin të shtrirë në tokë. Ishte i plagosur. E çuan në spitalin e UÇK-së në Drenoc/Drenovac, ndërsa, në të njëjtën mbrëmje, e transferuan në spitalin e Likocit/Likovac, ku, pas pak, Malushi dha shpirt. Në datën 13.05.1998, familjarët e kanë varrosur Malushin në varrezat e fshatit Ratkoc/Ratkovac.

**Burimet:** deklarata S.M, FDH-14563; deklarata R.K, FDH-12458; KMMLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816.

### Elmi (Binak) Morina

(5.03.1954, shqiptar nga Vrajaka/Vranjak, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk dhe transportues, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Elmi aderoi në UÇK në muajin mars të vitit 1998. Në datën 11.05.1998, forcat serbe e vendosën rrethimin e **Vrajakes/Vranjak**. Atë ditë, Elmi rastisi që të ishte në pozicionet e ushtrisë. Ka gjetur vdekjen më **12.05.1998**, në rrugë prej fshatit të tij në drejtim të Drenocit/Drenovac, ku u nis që tu çonte ushtrisë armatime. Varrimi i Elmiut u bë në varrezat e Vrajakës/Vranjak, më 13.05.1998.

**Burimet:** deklarata K.M, FDH-33493; KM-DLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26-092.

### Bajram (Sejdi) Himaj

(10.05.1932, shqiptar nga Gexha/Gedža, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, tetë fëmijë)

Forcat serbe parakaluan nëpër Gexhë/Gedža më 13.05.1998. Shtënin mbi shtëpitë shqiptare. Bajrami e ka larguar menjëherë familjen nga fshati dhe e ka strehuar te Muharrem Berisha në Prizren. Ai me djemtë Shemsidinin dhe Muharremin kanë mbetur në fshat. Ditën e nesërme, më **14.05.1998**, forcat serbe e nisën sulmin kundër një grupi të pjesëtarëve të UÇK-së, që ishin të pozicionuar në pyllin e afërt. Për një çast, disa ushtarë të UÇK-së e zunë pozicionin prapa murit të oborrit të Bajramit. Kjo i bëri ushtarët serbë që të fillojnë të gjuanin drejt shtëpisë së Bajramit. Për shkak të shtënave intensive, diku nga ora 10:00, djemtë e Bajramit vendosën të arratiseshin nga shtëpia, por ai vet nuk deshi të largohej nga shtëpia [**Gexhë/Gedža**]. Ushtarët e UÇK-së, që u fshehshin prapa murit të oborrit të familjes Himaj, u thanë më vonë Muharremit dhe Shemsidinut se Bajrami kishte mbetur në brendi të shtëpisë, kur ata, rreth orës 14:00, u larguan nga oborri. Ditën tjetër, Muharremi u kthye në shtëpi. E gjeti trupin e pajetë të Bajramit në oborr. Ishte qëlluar me një plumb në stomak. Muharremi e ka bartur trupin e të atit në brendi të shtëpisë. Dy ditë më vonë, Muharremi dhe Shemsidini, me ndihmën e komshinjve, e kanë varrosur Bajramin në oborr. Nëntë vjet më vonë, më 14.05.2007, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Bajramit në varrezat lokale.

**Burimet:** deklarata S.Z. FDH-15495; KMMLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 149, FDH-23816.

### Qamil (Islam) Himaj

(1933, shqiptar nga Gexha/Gedža, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, dy fëmijë)

Qamili ka qenë vejan dhe jetonte vetëm në shtëpi. Vajzat i kishte të martuara. Ato me familjet e veta jetonin në Rakoc/Ratkovac. Për shkak të përleshjeve të armatosura mes UÇK-së dhe forcave serbe në datën **14.05.1998**, popullata e braktisi Gexhën/Gedža. Qamili u tha të afërmeve se ai nuk